

ALI PASHË TEPELENA DHE ETNITË E PASHALLËKUT TË JANINËS NË VROJTIMET E LIKUT

ALI PASHA OF TEPELENI AND THE ETHNIC GROUPS IN THE PASHALIK OF IOANNINA IN LEAKE'S OBSERVATIONS

Shpresa Hoxha

S'ka dyshim se në vargun e udhëtarëve më të rëndësishëm të shek. XIX, që vizituan Shqipërinë, ishte ushtaraku dhe diplomati anglez, studiuesi i lash-tësisë dhe i albanologjisë, William Martin Leake. Në Shqipëri, siç dihet, erdhi në fund të vitit 1804. Bëhet e ditur se në fillim të vitit 1805 erdhi në Tepelenë ku takohet me Ali Pashë Tepelenën. Paraprakisht, zuri konak në shtëpinë e Jusuf Agë Arapit, ku qëndroi prej 28. XII 1804 e deri më 6. I 1805. Aty mblo-dhi të dhënat për Pashain shqiptar, për fjalorin e tij, për oborrin dhe për politikën e tij.

Për Likun, Ali Pasha kishte një qëndrim të vrazhdë ndaj njerëzve, ndërsa greqishten e shkruante si është më së keqi. Sidoqoftë ato pak fjalë për Pashain shqiptar, Liku i përmend nëpërmes një shtojce të veprës: "Ali Pasha", të cilën e ka shkruar biografi i tij Haxhi Shehreti. Porse në këtë shtojcë të kësaj vepre, Haxhi Shehreti flet shumë pak për ka-

rakterin e Pashait shqiptar dhe se ai më tepër bën fjalë për veprimet politike të Ali Pashë Tepelenës, deri te nënshtrimi i suljotëve në vitin 1803. Në fund të fundit, Liku duke dhënë një mendim rreth veprës së Haxhi Shehretit thekson: "Duke e studiuar veprën e poetit për Pashain shqiptar në vargje, pra duke folur për një burim historie rreth një figure, nuk duhet lënë anash faktin se autori ka lajthitje në vlerësime dhe si mysliman me fe, i konsideron të krishterët si racë më e ulët". Kështu, gjithnjë sipas Likut "tradhtia dhe vrazhdësia e Ali Pashës si hero i veprës përbëjnë dy tipare të shenjta të respektuara të mençurisë dhe të forcës së tij."¹

Në vitet 1788-1803 Pashallëku i Janinës shtrihej prej viseve në jug të lumit Shkumbin e deri te Arta. Si te koha kur Ali Pashë Tepelena i nënshtroi suljotët, ndërsa më vonë Beratin, tërë Çamërinë, Gjirokastrën dhe Delvinën. Pashallëku i tij tashmë përfshinte tërë Shqipërinë e

Jugut, Akarnaninë, një pjesë të Etolisë, Morenë dhe një pjesë të rëndësishme të Maqedonisë.² Pashallëku i Janinës në fakt, me prona të mëdha formonte një katërkëndësh kënddrejtë me grykën e Vardarit, në gjirin e Korintit, me Gjirin e Selanikut, me fushat e Thesalisë dhe me vargmalet e larta të Pindit. Në këtë shtet të madh jetonin afërsisht dy milionë banorë me shumicë shqiptarë dhe grekë, dhe pak vllahë e çifutë.³

Në fillim të shek XIX, kur Liku shkeli për herë të parë në Shqipëri, Pashallëku i Janinës kishte qenë në kulmin e fuqisë së vet, ndërsa Janina ishte qendër e njohur e zhvillimit ekonomik, e jetës shoqërore politike dhe kulturore e shqiptarëve. Aty feudalët shqiptarë formuan aristokracinë feudale të qytetit dhe kohë pas kohe karvanët e tyre tregtare, të cilat i tejkalonin kufijtë e Ballkanit, duke i eksportuar mallrat e tyre në tregjet e Vjenës, të Triestes, të Odesës, etj.

Në shkrimet e tij Liku nuk përmend strukturën e popullsisë në Pashallëkun e Ali Pashë Tepelenës, pra nuk bën fjalë për një popullsi të gjithmbarshme të Pashallëkut të Janinës. Një burim të vetëm e gjysmak e kemi nga autori frëng Bessier. Ai bën të ditur se në fillim të shek. XIX, popullsia e hapësirës gjeografike nën sundimin e Ali Pashë Janinës përbëhej prej 1.430.000 banorësh, prej të cilëve 748.000 grekë (ortodoksë shqiptarë e grekë), 662.000 myslimanë dhe 20.000 hebrej.⁴

Nga shënimet e studiuesve, të kon-

sujve të Fuqive të Mëdha dhe udhë-përshkruesve të dhjetëvjeçarëve të fundit të shek. XVIII dhe të dhjetëvjeçarëve të parë të fillimit të shek. XIX, bëhet e ditur se struktura e popullsisë në Pashallëkun e madh të Janinës ishte mjaft heterogjene. Është e kuptueshme që një krijesë gati shtetërore, si ajo e Ali Pashës, që përfshinte territorin prej Shqipërisë së Mesme deri në More, atë të Jugut, një pjesë të Maqedonisë së Egjeut, më tepër se gjysmën e Thesalisë dhe prej Çamërisë deri te Kanali i Korintit, kishte popullata të ndryshme.

Në krahinat jugore të Shqipërisë dhe në Çamëri dominonte popullsia shqiptare ku kishte pak turq, hebrej dhe një numër simbolik grekësh. Shqiptarët mbizotëronin në numër edhe në Çamëri, ndërsa në Janinë me rrethinë vërehej një përzierje e madhe shqiptare, greke, vllahë dhe një numër i konsiderueshëm hebrejsh.

Është për t'u vënë në dukje se Liku i jep një hapësirë të madhe pranisë së grekëve dhe të vllahëve, por jo në kryeqendrën e Pashallëkut të Janinës me rrethinë. Ai duke i përmendur vllahët bën të ditur se ata jetonin pranë shqiptarëve rreth fushës së Devollit e liqenit të Prespës. Liku merret pak a shumë edhe me historinë e vllahëve si një kategori e veçantë etnike që në fillim të shek. XII. Përndryshe, koloneli i artillerisë angleze, na mëson se gjatë kohës së udhëtimeve të tij nëpër rajonet e Pashallëkut të Janinës, vllahët e Greqisë i quanin, si thotë ai "Tzuban"

(Pastores), dmth. çobanë.⁵

Në kapitullin e tretë të veprës: “*Kërkime në Greqi*”, vështrimet e Likut shkojnë përtej prezantimit të gjuhës shqipe e të greqishtes, pra shkojnë edhe tutje prezantimit të historisë së shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe. Këtë herë ai merr në konsideratë një analizë të shkurtër, por të qëlluar për vllahishten e bullgarishten, duke i rrokur gjithnjë në kontekst me shqipen e greqishten. Ishte plotësisht e logjikshme që Liku me gjithë njohuritë modeste për vllahishten e bullgarishten, në kërkimet e tij të merrej me këto dy gjuhë, të paktën në planin leksikografik, duke pasur para së gjithash faktin se pranë shqiptarëve jetonin vllahët dhe një përqindje e vogël e bullgarëve në fushën e Devollit e në pellgun e liqenit të Prespës. Këtu me gjasë, për simbiozën e shqiptarëve me këta të fundit, Liku kishte parasysh simbiozën shqiptaro – bullgare, s’ka dyshim me një epërsi tejet të madhe numerike mbi këto të dyja në kufijtë e sotëm administrativ të Shqipërisë.

Historia e vllahëve është, megjithatë ajo, që për albanologun dhe ballkanologun anglez është prioritet në paraqitjen e vllahëve përbrenda këtij kapitulli. Kështu për vllahët e Greqisë (e të Shqipërisë - vërejtja jonë), ai bën të ditur se ata dalin në skenën historike kur edhe shqiptarët, dmth., aty rreth shek. XI dhe XII.⁶

Sidoqoftë mendimi i tij se nga transaksionet, ndryshimet e pozitës së vllahëve që nga ajo kohë e deri te

rënia e Konstantinopojës (më 1204 nga kryqëtarët e kryqëzatës së katërt, sipas Likut f. 243, kurse rënia definitive e saj ndodhi më 1453, me pushtimin e Konstantinopojës nga Sulltan Mehmeti – Pushtuesi), të lidhura me identitetin e gjuhës vllahë dhe që dëshmojnë se ata ishin një degë e kombit rumun. Konsideroj se ky mendim i tij është i drejtë dhe nuk bie në kundërshtim me literaturën e sotme historike dhe gjuhësore për vllahët dhe vllahishten. Natyrisht këtu Liku bën fjalë për afërsisht për djepin eventual, të të parëve të vllahëve, i cili ishte në anën veriore të rrjedhës së Danubit të poshtëm, të njohur me emrin Vllahia. Bie në sy po ashtu se Liku nuk bën fjalë për një kategori të veçantë etnike të quajtur arvanito-vllah, të pranishëm me gjasë që nga fillimi i shek. XIV në rrafshnaltën e Thesalisë aty ku dikur shqiptarët kishin qenë një tërësi e posaçme etnike para se të shtegtonin drejt Beotisë dhe Atikës.⁷

Liku në vijim, duke udhëtuar nga njëri vend në tjetrin, vë në dukje se fjala vllah nga grekët shpesh zihet ngoje edhe për shqiptarët edhe për vllahët, ngase këtë atribut kujtoj se grekët iu mveshin këtyre dy popujve sa për të dëshmuar jetën e tyre endacake dhe aq edhe për t’i nënçmuar në organizimin e jetës së tyre baritore. S’do mend se, dijetari anglez nuk bën fjalë këtu për atributin ndonjëherë negativ të termit vllah, për shqiptarët, porse ai bën fjalë për një grup malësorësh si thotë ai “grekë” të Moresë dhe barinj të Arkadisë që në

fakt kanë mundur të ishin në një pjesë të madhe shqiptarë. ⁸Përndryshe ai konsideron se gjuha vllahe në Greqi kishte mbizotëruar në malet e Pindit e të Olimpinit, në Shqipëri, në kreshtat e tërthorta të Maqedonisë Veriore e të Thesalisë. Po ashtu, Liku bën të ditur se vllahët e vërtetë kanë huazuar alfabetin ilir (*mendojmë alfabetin shqip – vërejtja ime*), të cilin ata e përdorin.⁹

Në fund të vështrimeve relativisht të pasura historike për vllahët, më pak për shqiptarët e për bullgarët, Liku përmend fjalorin katër gjuhësh të cilin në greqisht ai e quan: “Lexicon Tetraglosson”, që si thotë ai është shtypur me shkronja greke pesëdhjetë vite më parë në Voskopojë.¹⁰

Duke bërë fjalë për gjuhën shqipe dhe greqishten, dhe duke bërë një analizë të shkurtër për vllahishten dhe bullgarishten, në kontekst me shqipen dhe me greqishten, ai shkurt përmend popullatën sllave, përveç atyre të Manastirit, Prilepit, Ohrit, Prespës etj., të cilët i quan me emër të njohur bullgarë. Pra ai nuk bën fjalë për sllavo-maqedonët por për bullgarët në këto rajone. Ai vë në dukje se pranë shqiptarëve rreth fushës së Devollit e liqenit të Prespës, jetojnë vllahët dhe një përqindje e vogël e bullgarëve.¹¹ Kur flitet për simbiozën e shqiptarëve me këta të fundit, Liku kishte parasysh simbiozën shqiptaro-bullgare, por pa dyshim me një epërsi numerike mbi etninë bullgare dhe vllahe, në viset e sotme të Shqipërisë.

Siç u përmend më sipër, William Martin Leake-u nuk shkruan askund në veprat e tij për popullin sllavo-maqedon, as për shtetin e Maqedonisë. Popullsinë sllave të këtyre viseve ai e quan me të drejtë bullgare, ndërsa territorin e shtetit të Maqedonisë së sotme e quan me termin e vjetër gjeografik “Macedonia” dmth. Maqedoni.¹²

SUMMARY

William Martin Leake, the English special envoy from 1804 – 1809 from the British Government was charged with the mission of the political-strategic observer in the Northern Greece and in the Southern Albania.

Living inside the Court of Ali Pasha of Tepeleni, the sojourn of the English diplomat except of the political – military character it also had the research and scientific character. The English diplomacy of that time was in the crossroads and when the strategic authority of the British Kingdom in the Jon Sea was endangered, the Pashalik of Ali Pasha of Tepeleni played a very important part for the fulfilment or miscarriage of the long term plans of England in this part of the Balkans.

The English missionary obviously had known the presence of the other people that had been living in the great Pashalik of Ali Pasha of Tepeleni. He wrote about Greeks, Walachians, Bulgarians, etc. So, he considered Walachians as an ethnic group, while their

ancestors' ancient cradle was in the northern part of the Lower Danube, meanwhile for their language he made known to us that they used Walachian and that they borrowed the Illyrian alphabet by the meaning of the Albanian alphabet. In this composition of multiethnic symbiosis, based on his work "Researches in Greece", it comes out that he had noticed the Albanian - Bulgarian symbiosis in the nowadays Southern Albania.

Me pak fjalë

William Martin Leake, i dërguari special i Anglisë prej vitit 1804 deri në vitin 1809, nga Qeveria Angleze u ngarkua me detyrë të vëzhguesit politik - strategjik në Greqinë Veriore dhe në Shqipërinë Jugore.

Duke jetuar pranë oborrit të Ali Pashë Tepelenës, qëndrimi i diplomatit anglez, përveç karakterit politik-ushtarak, kishte edhe karakter kërkimor-shkencor. Diplomacia angleze atëherë gjendej në udhëkryq dhe kur Mbretërisë Britanike iu rrezikua autoriteti strategjik në Detin Jon, Pashallëku i Ali Pashë Tepelenës luante një rol të rëndësishëm për realizimin ose dështimin e planeve afatgjate të Anglisë në këtë pjesë të Ballkanit.

Misionari anglez shihet se e njihnte mirë edhe praninë e popujve të tjerë që jetonin në Pashallëkun e madh të Ali Pashë Tepelenës.

Ai bëri fjalë për grekët, për vllahët, për bullgarët etj. Vllahët kështu i konsideronte si etni, kurse djepi i lashtë i të parëve të tyre ishte në anën veriore të Danubit të poshtëm, ndërsa për gjuhën e tyre bënte të ditur se ata e përdornin vllahishten dhe se ata huazuan, si thotë ai, alfabetin ilir me kuptim të alfabetit të shqipes. Në këtë përbërje të simbiozës multietnike, duke u mbështetur, në veprën e tij "Kërkime në Greqi", del se ai kishte vërejtur edhe simbiozën shqiptaro - bullgare në viset e sotme të Shqipërisë Jugore.

Bibliografia

1. William Martin Leake, *Travels in Northern Greece*, London 1835, I, 463-464.
2. A. Andreades, *Ali Pacha de Tebelen, économiste et financier*, "Revue des études grecques" t. XX vol., Paris 1912, 437.
3. N. Pacelli, *I ikononiki politiki qe o plutos Ali Pacha ton Joaninon*, Athine 1936, 21.
4. J. Bessier, *Mémoire sur la vie e la puissance d'Ali Pacha, visir de Janina*, Paris 1820, 50; N. Pacelis, *I ikononiki politiki ke o plutos Ali Pasa ton Joaninon*, Athine 1936, 21.
5. W.M. Leake, *Researches in Greece*, London 1814, 364.
6. Po aty, 363.
7. Apost. E. Vakalopulu, *Istoria tu neu elinismu I*, Thessaloniki 1961, 31.; N.G.L. Hammond, *Migrations and invasions in Greece and adjacent areas*, New Jersey, 1976, 27.
8. William Miller, *A History of Frankish Greece (1204-1566)*, M.A. London 1908, 280.
9. W.M. Leake, *Researches in Greece*, 382.
10. Po aty, 382.
11. Po aty, 258.
12. Po aty, 238; 363-382.